



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 100, datë 29.02.2024

PËR

DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SE VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.02.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin, “*Mbi ecurinë e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, z. {...}*”, përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj. Fatmira Luli, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...};

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor dhe është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 157, datë 04.04.2023, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në Provimin e Pranimin në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023–2024, profili “*ndihmës ligjor*”, sipas nenit 34, pika 6, nenit 53, pika 4, dhe nenit 55, të ligjit nr.98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*” (më poshtë referuar si ligji “*Për Pushtetin Gjyqësor*”) si dhe në kreun V, të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor*” (referuar në vijim si vendimi 424/2020).

2. Kandidati ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla e Magjistraturës, në listën e renditjes së kandidatëve fitues në Programin e Formimit Fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2023–2024.

3. Në funksion të verifikimit në kohë të pasurisë dhe figurës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet dhe informacionet e subjekteve publike dhe private që, sipas ligjit, duhet t'i dërgohen Këshillit, sipas Vendimit nr. 473, datë 07.09.2023, u vendos fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2023–2024, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat. Në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës, për kandidatin si ndihmës ligjor z. {...}, si relatore u caktua znj. Fatmira Luli.

4. Në datën 07.09.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës;
- për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit treditor, kandidati depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare¹, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Në datën 12.09.2023, bazuar në pikat 65 dhe 66, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024.

7. Në datë 20.09.2023, u njoftua Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), për listën e kandidatëve për në programin e formimit fillestar, për të cilët do të kryhej deklarimi i pasurisë².

¹ Depozituar në Këshill me nr. 4652, datë 08.09.2023.

² Shih shkresën nr. 4853, datë 20.09.2023 drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

8. Brenda afatit treditor, kandidati depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse³ dhe brenda datës 29.09.2023, kishte detyrimin për të dorëzuar të plotësuar formularin e deklaramit të pasurisë, pranë ILDKPKI-së,

9. Gjatë procedurës së verifikimit, nga data 07.09.2023, bazuar në pikën 67/b, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024, ndër ta edhe për z. {...}.

10. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme.

11. Kandidati z. {...} me shkresën e datës 01.02.2024 drejtuar Këshillit ka bërë me dije tërheqjen, për shkak të arsyeve personale, nga vazhdimi i procedurave të mëtejshme në lidhje me pozicionin e ndihmësit ligjor.

12. Me shkresën nr. 178 prot., datë 09.02.2024⁴, Shkolla e Magjistraturës ka informuar Këshillin se z. {...}, me kërkesën e tij, të depozituar me nr. 131 prot., datë 31.01.2024, i është drejtuar Shkollës së Magjistraturës për heqjen dorë nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024.

II. PARASHIKIMET LIGJORE

13. Sipas pikës 1 të Kreut I, të Vendimit 424/2020 parashikohet se qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror dhe të proporcionalitetit, për zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në bazë të pikës 2/ii, ky vendim rregullon procedurat e verifikimit edhe për kandidatin fitues në provimin e pranimin në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.

14. Neni 29, i Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës parashikon: “2.Kandidatët për magjistratë, kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit të shpallur fitues nënshkruajnë marrëveshjen e regjistrimit, e cila parashikon të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit përgjatë Programit të Formimit Fillestar.

³ Depozituar në Këshill, me nr. 4757, datë 14.09.2023.

⁴ Shkresa është depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 703/1 prot., datë 09.02.2024.

3. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, kandidati për magistrat, kandidati për ndihmës ligjor dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit konsiderohet i regjistruar në Shkollën e Magjistraturës, në bazë të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit” (i ndryshuar) dhe Anekseve të kësaj Rregulloreje.” ...5. Refuzimi për nënshkrimin e marrëveshjes së regjistrimit, sjell, si pasojë, heqjen nga lista të fituesit dhe humbjen e së drejtës për të filluar dhe ndjekur Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Në këtë rast, Këshilli Drejtues i Shkollës raporton pranë KLGJ-së, KLP-së dhe Avokaturës së Shtetit, sipas rastit mbi situatën e krijuar....”.

15. Neni 95, i të Kodit të Procedurave Administrative parashikon: “Pamundësia në objekt apo qëllim”. Sipas këtij neni: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

III. SHQYRTIMI NGA KOMISIONI

16. Sa më lart parashtruar, nga ana e relatores u vlerësua se procedura e vlerësimit të pasurisë dhe figurës të filluar ndaj z. {...}, duhet të deklarohet e përfunduar, për arsye se ai nuk gëzon më statusin e kandidatit fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023 – 2024, prandaj çështja iu parashtrua për vlerësim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

17. Në mbledhjen e datës 16.02.2024, Komisioni miratoi propozimin e relatores për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, për z. {...}, për shkak të humbjes prej tij të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor dhe vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

IV. VLERËSIMI I KËSHILLIT

18. Nga interpretimi i dispozitave ligjore, si më lart cituar, del e qartë se organi publik, i cili zhvillon procedurën, detyrohet të deklarojë përfundimin e saj, në rastin kur konstaton ekzistencën e njërit prej rasteve të parashikuara nga neni 95, i Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë dispozitë përdoren terma ligjorë të përgjithshëm dhe të papërcaktuar siç janë “Pamundësia”, “objekti” dhe “qëllimi”, por, të cilat, duke u aplikuar në raste konkrete, qartësojnë dhe përcaktojnë vendimmarrjen e organit publik në lidhje me vazhdimësinë e procedurave, të filluara kryesisht nga ana e tij. Nga ana tjetër, duket i qartë interpretimi se

qëllimi i procedurës bëhet i pamundur, në rastin kur kryerja e një veprimi administrativ, ka humbur aktualitetin, për shkak të ndryshimit të rrethanave, të cilat mund të jenë faktike ose ligjore.

19. Tërheqja e z. {...} nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, ka sjellë si pasojë rënien e shkakut për të cilin kjo procedurë ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i saj nuk ekziston më. Z. {...} nuk ka më statusin e kandidatit fitues, status për shkak të të cilit ka filluar nga ana e Këshillit procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës. Për pasojë qëllimi i këtij procedimi është bërë i pamundur, çka pas sjell përfundimin e kësaj procedure pa vendim përfundimtar.

20. Deklarimi i përfunduar i procedurës, nuk zgjidh themelin e çështjes, fakt i cili nuk pengon fillimin kryesisht të procedurës apo me kërkesë të palës së interesuar, në kuadër të një procedure tjetër, me objekt dhe qëllim të përcaktuar në ligj.

21. Sa më lart parashtruar, vlerësohet se procedura e vlerësimit ndaj z. {...}, duhet të deklarohet e përfunduar, për arsye se z. {...} nuk gëzon më statusin e kandidatit fitues, cilësi dhe arsye mbi bazën e së cilës ka filluar procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga ana e Këshillit.

V. KONKLUSIONE

22. Në këto rrethana, duke vlerësuar se aktualisht, për z. {...}, verifikohet një e dhënë, e cila pengon vijimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës të filluar ndaj tij, referuar nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se një procedurë e tillë duhet të përfundohet, për arsye se z. {...} nuk gëzon më statusin e kandidatit fitues, cilësi dhe arsye mbi bazën e së cilës ka filluar procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga ana e Këshillit.

23. Në vijim, duke pasur në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se procedura e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, e filluar ndaj z. {...}, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar. Deklarimi i përfunduar i procedurës, nuk zgjidh themelin e çështjes, fakt i cili nuk pengon fillimin kryesisht të procedurës apo me kërkesë të palës së interesuar, në kuadër të një procedure tjetër, me objekt dhe qëllim të përcaktuar në ligj.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në nenin 53, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i

ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të z. {...}, të filluar me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR